



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

**RREGULLORE PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT
NË
ODËN EKONOMIKE TË KOSOVËS**

**Dhjetor 2023
Prishtinë**

Në bazë të nenit 18 të Ligjit mbi Odën Ekonomike të Kosovës dhe nenit 24 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës, Këshilli Drejtues i Odës Ekonomike të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 06.12.2023 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME PËR AKTIVITET E PROKURIMIT

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregull ka për qëllim që të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të mjeteve për aktivitetet e prokurimit duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që zbatohen, procedurat që ndiqen, të drejtat që respektohen dhe detyrimet që duhet të përmbushen nga subjektet që marrin pjesë ose interesohen për aktivitetet e prokurimit në Odën Ekonomike të Kosovës.
2. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha aktivitetet e prokurimit të mallrave, shërbimeve, personave fizik, operatorëve ekonomik dhe punëve në Odën Ekonomike të Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë këto kuptime:

1. "**OEK**" nënkupton Odën Ekonomike të Kosovës;
 2. "**Prokurim**" nënkupton blerjen, çdo mënyrë tjetër kontraktimi të mallrave, të shërbimeve ose të punëve në Odën Ekonomike të Kosovës;
 3. "**Kontratë**" nënkupton kontratën e lidhur me shkrim ndërmjet Odës Ekonomike të Kosovës me një apo më shumë ofertuese
- I
4. "**Zyrtar Autorizues**" nënkupton Kryetarin e OEK-ut.
 5. "**Ofertues**" nënkupton çdo person fizik apo juridike të cilit ofrojnë ekzekutimin e punëve, produkte apo shërbime.
 6. "**Procedura e veçantë**" nënkupton një procedurë prokurimit për vlera të vogla e cila zhvillohet për vlerat e përgjithshme të prokurimit deri në vlerën 1.000.00 (një mijë) € (euro),
 7. "**Procedura e kufizuar**" nënkupton procedurën e prokurimit ku cilido ofertues mund të parashtrijë ofertën e tij, por në kualifikim thirren vetëm ofertuesit e përzgjedhur nga organi kompetent.
 8. "**Procedura e negociuar**" nënkupton një procedure prokurimi të prokurimit në të cilën Oda si autoritet kontraktues, përzgjedh operatorin ekonomik sipas përzgjedhjes së saj dhe negociacion kushtet e kontratës me një apo më shumë operator ekonomikë.
 9. "**Prokurim i drejtpërdrejtë apo njëburimor**" nënkupton procedurën e prokurimit, në të cilin OEK pa pasur qëllim mosrespektimin e procedurave të tjera, hyn në marrëdhënie dhe kërkon një propozim (oferta) vetëm nga një ofertues e cila zhvillohet vetëm me vendim të Kryetarit të OEK-ut.
 10. "**Ftesa për tender**" nënkupton ftesën që u dërgohet ofertuesve për paraqitjen e tenderit dhe që specifikon procedurën, kërkesat e OEK-ut, kriteret kontraktuese dhe kushtet;
 11. "**Komisioni vlerësues i prokurimit**" nënkupton komisionin e caktuar për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të procesit të prokurimit sipas kësaj Rregullore;

Neni 3
Prokurimit
në
Odën Ekonomike të Kosovës

1. Politika e prokurimit siguron që blerjet të jenë me kosto efektive, procesi është transparent dhe jep vlerën më të mirë për para. Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve bëhet nën drejtimin dhe përgjegjësinë e Kryetarit të OEK-ut. Staf i përgjegjës mund të fillojë procesin e prokurimit për mallra dhe shërbime (material harxhues, pajisje zyre, kontratë shërbimesh, grante etj.) vetëm pasi të siguroheni që procedura të ndiqet siç thuhet më poshtë. Këto procedura nuk mund të zbatohen vetëm nëse procedurat e prokurimit të donatorëve ose pikat brenda procedurave të prokurimit të donatorëve janë më të rrepta se procedurat e prokurimit të OEK .

Neni 4

Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve i ngarkuar me buxhetin e operacioneve

1. Mallrat ose shërbimet deri në 2,500 € mund të blihen pa ndjekur procedurat e tenderit, por gjithmonë duhet të kërkonti çmime dhe oferta konkurruese. Për blerjen e mallrave ose shërbimeve mbi 2,500 € deri në 7,500 €, procedura e prokurimit duhet të ketë të paktën tre oferta të dokumentuara dhe ofertën më të mirë të përshtatshme për tu aplikuar (prokurimi me ftesë). Për blerjen e mallrave ose shërbimeve mbi 7,500 €, procedura e prokurimit bëhet me tender publik, zakonisht publikohet në web faqe të OEK www.oek-kcc.org ose në raste nevojë edhe në portalet e ndryshme. Ofertat mblidhen dhe rekomandohet të jenë jo më pak se tri oferta, përparësi kanë anëtarët e OEK-ut.

Neni 5

Iniciativa për fillimin e procedurës

1. Kryetari i OEK-ut, në cilësinë e funksionarit me kompetenca ligjore për të përkujdesur për funksionimin dhe ligjshmërinë e OEK-ut, identifikon nevojën për iniciimin e procedurave të prokurimit.
2. Me rastin e identifikimit të nevojave, qofshin ato për furnizim, mallra, shërbime të caktuara apo kryerje të punëve, Kryetari aprovon vlerat që apo nuk tejkalojnë shumën deri në 1,000€.
3. Me rastin e identifikimit të nevojave për blerjen e mallrave ose shërbimeve mbi 2,500€ deri në 7,500€, Kryetari i OEK-ut, formon Komisionin i cili fillon procedurat e prokurimit, ku duhet të kenë të paktën tre oferta të dokumentuara dhe ofertën më të mirë të përshtatshme për tu aplikuar (prokurimi jopublik).
4. Për blerjen e mallrave ose shërbimeve mbi 7,500€, procedura e prokurimit bëhet me tender publik, zakonisht publikohet në web faqe të OEK www.oek-kcc.org ose në raste nevojë edhe në portalet e ndryshme. Ofertat mblidhen dhe rekomandohet të jenë jo më pak se tre. Kryetari i OEK-ut, formon Komisionin i cili fillon procedurat e prokurimit.
5. Për të gjitha procedurat e prokurimit formohet Komisioni i cili përbëhet nga 3 anëtarë (Staf i OEK-ut). Komisioni duhet të përpiloj raportin me shkrim, të cilin raport duhet t'ia dërgoj Kryetarit për aprovim, pastaj Kryetari i OEK-ut do të vendos për miratim.

Neni 6

Fillimi i procedurës së prokurimit

1. Procedura e prokurimit fillon pas aprovimit nga Kryetari i OEK-ut dhe fillon me publikimin e ftesës për ofertim për të vazhduar me publikimin e njoftimit për kontratë.

2. Publikimi i njoftimit për kontratë bëhet përmes publikimit në Web- faqen e OEK-ut dhe sipas nevojës edhe në portale tjera.

3. Pas publikimit të njoftimit për kontratë subjektet e interesuara mund të drejtohen shërbimit profesional gjegjësisht zyrtarit të autorizuar për ta siguruar dosjen e ofertës. Subjektet e interesuara lidhur me detajet dhe sqarimet shtesë mund të kërkojnë sqarime të tilla dhe se sqarimet e ofruara nga OEK, do ti dërgohen ofertuesve tjerë.

4. Kërkesa për sigurim të dosjes mund të bëhet vetëm nëse kërkesa e tillë është bërë para skadimit të afatit për paraqitje të ofertave nga ofertuesit. Shërbimi profesional do të sigurojë në bazë të kërkesës së palëve të interesuara dosjen në afat prej 3 ditëve, nga dita kur është paraqitur kërkesa e tillë.

Neni 7

Njoftimi për kontratë

Njoftimi për kontratë do të përmbajë të paktën këto nga informacionet:

- 1.1 Përshkrimin e përgjithshëm të qëllimit të kontratës;
- 1.2 Limiti kohor për parashtrimin e kërkesave për sigurim të dosjes së tenderit;
- 1.3 Shumën e përgjithshme buxhetore e parapatë për vlerën e kontratës;
- 1.4 Lloji i kontratës për të cilën është shpallur njoftimi;
- 1.5 Kohëzgjatja e kontratës apo afatet kohore për përfundim;
- 1.6 Informacionet ekonomike, financiare dhe teknike;
- 1.7 Kushtet për pjesëmarrje;
- 1.8 Kushtet e veçanta të kontratës;
- 1.9 Lloji i procedurës së prokurimit;
- 1.10 Kriteret e dhënies;
- 1.11 Informacionet administrative dhe
- 1.12 Informacionet lidhur me të drejtën e ankimimit dhe informacionet e tjera shtesë.

Varësisht nga nevojat dhe lloji i kontratës që synohet të lidhet, përbërja e njoftimit për dhënie të kontratës mund të ndryshojë. Përpilimi i njoftimit për nevoja të veçanta bëhet në konsultim me Kryetarin.

Neni 8

Përgatitja e dosjes së tenderit

1. Pas autorizimit të nismës për hapjen e procedurës së prokurimit, Kryetari do të caktojë komisionin për caktimin e specifikimeve të tenderit.
2. Komisioni për specifikime do të përbëhet nga tre anëtarë (staf i OEK-ut), të cilët do të përcaktohen varësisht nga nevoja konkrete me qëllim të lidhjes së kontratës, duke pasur parasysh përgatitjet dhe njohuritë e tyre lidhur me objektin e kontratës.
3. Komisioni për specifikime do të përgatisë specifikimet lidhur me nevojën e shprehur për lidhje të kontratës duke identifikuar standardet cilësore për zbatim sa më të suksesshëm.
4. Komisioni për specifikime do të përcaktojë gjithashtu kushtet e veçanta të kontratës, të cilat do t'u përgjigjen specifikimeve të përcaktuara për lëndën e kontratës.

Neni 9

Afatet e tenderëve

1. Tenderët, respektivisht ftesa e drejtuar për ofertim, do të qëndrojnë e hapur sipas Llojit të kontratës dhe madje:
 - 1.1. Kontratat me vlerë të madhe vlera e të cilave tejkalon 10.000.00€ do të jetë e hapur në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga cila e publikimit;

1.2. Kontratat me vlerë të mesme vlera e të cilave është deri në 10.000,00€ do të jetë e hapur në afat prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit;

2. Në raste të jashtëzakonshme, afatet e përcaktuara mund të shkurtohen për shkak të rrethanave të veçanta që e bëjnë të nevojshëm shkurtrimin e afateve të tilla.

3. Kur vlerësohet se është në interes të zhvillimit të suksesshëm të procedurës së prokurimit, afatet mund të zgjaten më së shumti për kohën e dyfishtë sa është paraparë për llojin e kontratës.

Neni 10

Hapja e ofertave

1. Hapja e ofertave bëhet nga Komisioni për hapjen e ofertave, i cili përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve.
2. Pas përmbylljes së afatit për dorëzimin e ofertave nga ofertuesit, Komisioni do të konstatojë se a ekzistojnë kushtet për të zhvilluar procedurën e hapjes së ofertave. Kushti themelor për të zhvilluar procedurën e hapjes së ofertave është se për ftesën për ofertim të paktën 3 (tre) operatorët ekonomikë kanë parashtruar ofertat e tyre.
3. Në rast se nuk është përmbushur kushti për hapje të ofertave, ftesa për ofertim duhet të ri publikohet dhe nëse edhe pas ripublikimit nuk është përmbushur kushti atëherë do të merren për bazë vetëm ofertat e parashtruara të cilat i kanë plotësuar kushtet.
4. Komisioni për hapje të ofertave, pasi që ka konstatuar se ekzistojnë kushtet për të bërë hapjen e ofertave, në afat jo më të largët se 7 ditë do të caktojë datën, kohën dhe vendin e hapjes së ofertave.
5. Komisioni me rastin e hapjes së ofertave do të bëjë leximin e ofertës në kuptim të çmimit dhe specifikimit të objektit të ofertës, përfshirë të dhënat që kanë të bëjnë me kushtet e veçanta që janë të specifikuar në njoftimin për kontratë.
6. Me rastin e leximit të të dhënave njëri nga anëtarët e Komisionit që është caktuar për leximin e ofertave, pas çdo segmenti të lexuar do të kërkojë konfirmimin e të pranishmëve se a e kanë kuptuar të dhënë e lexuar dhe se a ka nevojë që e dhëna e tillë të përsëritet.
7. Komisioni me rastin e hapjes së ofertave do të mbajë evidencë në procesverbalin e veçantë në të cilin do të shënohen hapja e ofertave, vërejtjet e mundshme të pjesëmarrësve, të pranishmit në hapjen e ofertave, ofertat që janë hapur dhe çështje të tjera, që konsiderohen si të rëndësishme për evidencë.

Neni 11

Vlerësimi i ofertave

1. Vlerësimin e ofertave e bën Komisioni për vlerësim, i cili ka 3 (tre) anëtarë dhe zgjidhet nga Kryetari i Odës.
2. Vlerësimin e ofertave e bënë Komisioni për vlerësim, i cili ka 3 (tre) anëtarë. Komisioni për vlerësim do të bëjë vlerësimin e ofertave në mbledhje të mbyllur pa praninë e përfaqësuesve të ofertuesve.

Neni 12

Mënyra e vlerësimit

1. Komisioni për vlerësim do të bëjë vlerësimin e ofertave duke u mbështetur në kriteret e mëposhtme:
 - Oferta më e favorshme ekonomikisht;
 - Çmimi më i ulët i ofruar; dhe
 - Konformiteti cilësor i ofertës.

- Anëtarësia në OEK.
1. Komisioni për vlerësimin e ofertave, brenda afatit duhet të shqyrton secilën ofertë dhe zgjedh ofertën më të përshtatshme dhe me të favorshme për OEK.
 2. Komisioni për vlerësim do t'i japë përparësi ofertës që përmban konformitetin cilësor të objektit të ofertës, duke u bazuar në arsyetimin e çmimit të ofruar.
 3. Gjatë vlerësimit të ofertave Komisioni ka të drejtë që të kërkojë sqarime shtesë nga ofertuesi lidhur me paqartësitë teknike.
 4. Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material, apo në cilindo aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet. OEK do të caktojë afat kohor të arsyeshëm për ofertuesin për sqarim të tenderit të tyre. Nëse ofertuesi dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga OEK, tenderi përkatës do të refuzohet.

Neni 13

Eliminimi i ofertave

1. Komisioni për vlerësim do të diskualifikojë ofertuesit, të cilët nuk kanë arritur të parashtrajnë ofertat e tyre në harmoni me kushtet që janë përcaktuar me nenin 12 të kësaj Rregulloreje.
2. Komisioni për vlerësim do të diskualifikojë ofertuesit, të cilët nuk kanë arritur të parashtrajnë ofertat e tyre në harmoni me kushtet që janë përcaktuar paraprakisht.
3. Krahas mos përmbushjes së kushteve, ofertuesit do të diskualifikohen edhe në rast të parregullsive në dosjen e bashkëngjitur me ofertën, që ndërlidhet me dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të kontratës.
4. Komisioni për vlerësim, për secilin ofertues do t'i shënojë arsyet e refuzimit në procesverbalin e vlerësimit.

Neni 14

Njoftimi për dhënie të kontratës

1. Njoftimi për dhënie të kontratës do të bëhet në të njëjtën mënyrë sikurse njoftimi për kontratë siç përkufizohet me neni 7 të kësaj Rregullore.
2. Nga dita kur është caktuar ofertuesi, ofertuesit që nuk janë kualifikuar që kanë marrë pjesë në procedurën e tillë të prokurimit, kanë të drejtë që të parashtrajnë ankesat e tyre.
3. Kontrata me ofertuesit më të suksesshëm nuk do të lidhet deri në kalimin e afatit për ankesë, respektivisht deri në vendosjen mbi ankesat eventuale të ofertuesve të tjerë.

Neni 15

Anulimi i procedurës së prokurimit

1. OEK, nga njoftimi për kontratë, hapjes së ofertave, vlerësimit të tyre e deri në procedurat e animimit, mund të anulojë procedurën e prokurimit.
2. Anulimi i procedurës së prokurimit mund të bëhet për shkak të mos përmbushjes së kushteve dhe kriterëve që kërkohen nga OEK apo kur në bazë të ankesës së ofertuesve, që marrin pjesë në procedurën e prokurimit, evidentohet parregullsia e cila vë në dyshim objektivitetin e procedurës së zhvilluar të prokurimit.
3. Vendimi për anulim të procedurës së prokurimit bëhet varësisht nga Komisioni i cili vlerëson mos përmbushjen e kushteve për vazhdim të procedurave të prokurimit.
4. Njoftimi për anulim të procedurës së prokurimit do të bëhet në mënyrë elektronike

përmes e-mail-it, tek ofertuesit mënyrë të njëjtë sikurse është përcaktuar me nenin 5 të kësaj Rregullore.

5. Njoftimi për anulim të procedurës së prokurimit do të bëhet në mënyrë të njëjtë sikurse është përcaktuar me nenin 5 të kësaj Rregullore.
6. Procedura e anuluar e prokurimit do të përsëritet jo më larg se 30 (tridhjetë) ditë, nga dita kur vendimi me të cilin është anuluar procedura e prokurimit është bërë i formës së prerë.
7. Ofertuesit që kanë marrë pjesë në procedurën e anuluar të prokurimit kanë të drejtë që të parashetrojnë ankesën e tyre në afat prej 5 ditëve, nga dita kur është bërë njoftimi për anulim të procedurës së prokurimit.

Neni 16

Lidhja e kontratës

1. Me përfundimin e afatit për ankesë, pasi që të ketë kaluar afati i ankimit apo është vendosur për ankesat eventuale nga ana e organit kompetent, OEK do të lidhë kontratën me ofertuesin, i cili është përzgjedhur në bazë të procedurës së prokurimit.
2. Lidhja e kontratës, do të bëhet jo më larg se 5 ditë, pas përmbylljes së procesit të ankesave.
3. Kontrata lidhet me nënshkrimin e saj nga Kryetari I OEK-ut, dhe përfaqësuesit e autorizuar të Ofertuesit.

Neni 17

Ankesat në procedurë të prokurimit

1. Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit ofertuesit kanë të drejtën në ankesë, dhe madje për:
 - 1.1 të drejtën në ankesë që ka të bëjë me ofrimin e dosjes së tenderit në procedurë të njoftimit të kontratës;
 - 1.2 të drejtën në ankesë me rastin e vlerësimit të ofertave, respektivisht njoftimit për dhënie të kontratës;
 - 1.3 të drejtën në ankesë për anulim të procedurës së prokurimit,
2. Ankesat duhet të parashetrohen në afat prej 5 (pesë) ditësh, nga dita kur palët janë njoftuar, respektivisht kur është bërë njoftimi zyrtar lidhur me ndonjërin nga rrethanat e përcaktuara.
 3. Ankesat e ofertuesve parashetrohen te Kryetari i OEK-ut, i cili do të vendosë për ankesat eventuale, jo më larg se 30 ditë nga dita kur është dorëzuar ankesa. Përfundimisht nga raste të tjera, vetëm ankesa ndaj njoftimit për dhënie të kontratës e pezullon procedurën e prokurimit.

Neni 18

Qasja në dosjet e ofertuesve

1. Dokumentacionet e dorëzuara nga ofertuesit konsiderohen si dokumentacion që përmban sekret afarist.
2. Në rastet kur ofertuesit kërkojnë qasje ekskluzive lidhur me dosjet e ofertuesve të tjerë, kërkesat e tilla do të refuzohen nga OEK duke konsideruar si cenim të sekretit afarist.

Neni 19

PROCEDURAT E VEÇANTA TË PROKURIMIT

Procedura e prokurimit për vlera të vogla

1. Procedurat e prokurimit për vlera të vogla zhvillohet për vlerat e përgjithshme të prokurimit deri në vlerën 2,500.00 (një mijë) € (euro), dhe mund të blihen pa ndjekur procedurat e prokurimit, por gjithmonë duhet të kërkojnë çmime dhe oferta konkurruese. Me rastin e identifikimit të nevojave, qofshin ato për furnizim, shërbime të caktuara apo kryerje të punëve, Kryetari aprovon vlerat që nuk tejkalojnë shumën mbi 1,000€.

2. Furnizimet, blerjet apo kryerja e punëve për nevojat dhe veprimtaritë e Odës, që nuk tejkalojnë vlerën e përgjithshme deri 2,500.00 €, do të porositen në mënyrë të drejtpërdrejtë pa pasur nevojë për të siguruar 3 (tri) Oferta, për porosinë e bërë nevojitet aprovimi paraprak i Kryetarit të OEK-ut.
3. Kriteret për përzgjedhjen e ofertës, siç është përkufizuar me nenin 12 të kësaj Rregulloreje, do të jenë të zbatueshme edhe për këtë lloj të procedurës së prokurimit.

Neni 20

Procedura e prokurimit e kufizuar

Proceduar e kufizuar - nënkupton procedurën e prokurimit ku cilido ofertues mund të parashtojë ofertën e tij, por në kualifikim thirren vetëm ofertuesit e përzgjedhur nga organi kompetent.

1. Përzgjedhjen e së paku 3 ofertuesve, në mesin e ofertuesve të tjerë, e bënë Komisioni pas aprovimit nga Kryetari I OEK-ut, për ofertat e pranuar.
2. Pas përzgjedhjes së tre ofertuesve, pjesa tjetër e procedurës do të zhvillohet në përshtatje sikurse procedura e hapur e prokurimit.
3. Vlera e kontratave të cilat lidhen përmes këtij lloji të procedurës së prokurimit nuk e tejkalon vlerën e përgjithshme të kontratës më shumë se 7,500.00 €.

Neni 21

Procedura e prokurimit të negociuar

1. Procedura e prokurimit e negociuar- nënkupton procedure të prokurimit në të cilën Oda si autoritet kontraktues, përzgjedh operatorin ekonomik sipas përzgjedhjes së saj dhe negociacion kushtet e kontratës me një apo më shumë operator ekonomikë.
2. Procedura e prokurimit të negociuar do të bëhet në këto raste:
 - 2.1. Natyra e punëve, furnizimit apo shërbimit nuk lejojnë caktimin paraprak të çmimeve të përgjithshme;
 - 2.2. Specifikimet nuk mund të përkufizohen në detaje të mjaftueshme për të lejuar përzgjedhjen e ofertuesit më të suksesshëm, siç mund të realizohet në procedurën e hapur apo të kufizuar;
3. Ekziston rreziku që për shkak të natyrës së veçantë të lëndës së kontratës mund të paraqitet rreziku objektiv për shkaktimin e dëmit material.
4. Negocimi me operatorët ekonomikë do të bëhet nga komisioni i zgjedhur nga Kryetari I OEK-ut. Me rastin e negociimit do të merren për bazë kriteret e përcaktuara.
5. Kryetari I OEK-ut, do të nënshkruajë kontratën në bazë të rekomandimit të Komisionit pasi që kanë përfunduar negociatat me 1 (një) apo më shumë operatorë ekonomikë, për të cilët është konsideruar se mund të ofertojnë sipas kushteve specifike që kërkohen për procedurën e negociuar të prokurimit.

Neni 22

Procedura e prokurimit njëburimor dhe ndërkombëtar

1. Në të gjitha rastet kur konsiderohet se kryerja e një pune, furnizimi i caktuar apo kryerja e shërbimeve të veçanta, kërkohet nga një operator i cili posedon kapacitete të veçanta, qoftë në kuptim të burimeve njerëzore, dijes, posedimit të mjeteve të veçanta apo elementeve të tjera që e bëjnë jo-konkurrues me operatorë të tjerë, OEK-u, do të zhvillojë procedurë të veçantë të prokurimit.
2. Procedura e prokurimit njëburimor dhe atij ndërkombëtar mund të zhvillohen vetëm në bazë të vendimit të Kryetarit të OEK-ut.

3. Prokurimi me burim të vetëm mund të përdoret për blerje shumë specifike, unike të mallrave dhe shërbimeve, kur pasi të vlerësohet oferta e tregut, gjendet vetëm një ofrues i kualifikuar.

3.1. Për prokurimin me burim të vetëm të ngarkuar në buxhetin e operacioneve për blerjen e mallrave ose shërbimeve mbi 2,500 euro deri në 7,500 euro, një anëtar nga Departamenti i Financave duhet të përfshihet në proces.

3.2. Për prokurimin me burim të vetëm të ngarkuar në buxhetin e operacioneve për blerjen e mallrave ose shërbimeve mbi 7,500 euro, Kryetari i OEK-ut, duhet të përfshihet në proces.

3.3. Në prokurimin me burim të vetëm për blerjen e mallrave mbi 50,000 EUR ose blerjen e shërbimeve mbi 150,000 EUR ose blerjen e mallrave dhe shërbimeve (të kombinuara në një kontratë) mbi 50,000 EUR, duhet të përfshihet një Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës.

3.4. Procedura e vetme e prokurimit duhet të justifikohet në memorandumin shoqërues të aprovuar nga Drejtori i Projektit / Menaxheri i Projektit dhe Kryetari i OEK-ut.

Neni 23

Nën kontraktimi

1. Nënkontraktimi nga Ofertuesi me rastin e ekzekutimit të kontratës së lidhur me OEK-un, është e lejuar vetëm me njoftimin paraprak, të cilin e bën Ofertuesi tek OEK-u.

2. Njoftimi duhet bërë me shkrim dhe t'i drejtohet Kryetarit të OEK-ut, i cili varësisht nga lënda e kontratës së prokurimit do ta miratojë apo do ta refuzojë nënkontraktimin e kërkuar nga Ofertuesi.

3. Për të gjitha çështjet që nuk janë paraparë në procedurat e prokurimit, do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe legjislacionin dhe praktika e prokurimit publik në Kosovë.

Neni 24

Zbatimi

1. Për të gjitha çështjet që nuk janë paraparë me këtë Rregullore do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe legjislacionin dhe praktika e prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja e Financiare e OEK-ut, me nr. protokoli 176 datë 21.02.2014.

Rregullorja ndryshohet dhe plotësohet në të njëjtën mënyrë siç është aprovuar.

Kjo Rregullore hynë në fuqi me 01.01.2024.

Këshilli Drejtues i Odës Ekonomike të Kosovës

Kryetar
Lulzim Rafuna



Adresa: Nëna Terezë, Nr:20, 10000 Prishtina – KOSOVË
Tel: + 383 (0) 38 224 741, Tel & Fax +383 (0) 038 224 299
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org